

VENDIM
Nr.817, datë 11.6.2008

PËR MIRATIMIN E VLERËS SË DËMEVE, TË SHKAKTUARA NË OBJEKTE, PRONË PRIVATE, SI RRJEDHOJË E AKSIDENTIT TEKNOLOGJIK, TË NDODHUR NË GËRDEC, DHE TË LISTAVE ME EMRAT E INDIVIDËVE E TË PERSONAVE FIZIKË A JURIDIKË, QË DO TË KOMPENSOHEN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së dëmeve, të shkaktuara në objekte, pronë private, si rrjedhojë e aksidentit teknologjik, të ndodhur në Gërdec, prej 935 900 412 (nëntëqind e tridhjetë e pesë milionë e nëntëqind mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekësh.

2. Miratimin e listave, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me emrat e individëve e të personave fizikë a juridikë, dhe me vlerat përkatëse të kompensimit, dalë nga procesi i vlerësimit dhe i rivlerësimit të objekteve, që kanë në pronësi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha